



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 220, Datë 20.12.2019

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 187, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

DHE

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 118/44 Prot, datë 16.11.2019, mbi një ndryshim në vendimet e bordit të ERE nr. 187 dhe nr.188 datë 10.11.2017,

**Konstatoi se:**

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 36, datë 04.03.2019, ka vendosur:

- *Të miratojë një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror” të ndryshuar si më poshtë:  
- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30 vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar...”*

Dhe me vendimin nr. 37, datë 04.03.2019 vendosi:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30 vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sekorin e Gazit Natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar..”

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.05.2019, si dhe shkresës nr. 52 prot, datë 17.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 354 prot., datë 20.05.2019, ka bërë me dije ERE-n për mbylljen e procesit të pajisjes me certifikata pronësie dhe ka njoftuar për zmadhimin e kapitalit.
- Në vijim, shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 122 Prot., datë 02.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 196/1 Prot, datë 02.12.2019, me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.06.2020, duke u shprehur se pajisja me dokumentet e kërkuara është një proces që kërkon kohë dhe është është në varësi të përgjigjes nga institucionet përkatëse.
- Gjithashtu me qëllim plotësimin e dokumentacionit, shoqëria “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes Mjedisore të (Tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a., deklaroi se ka parashikuar në Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2020, pagesën e certifikatës së sigurimit si shoqëri sigurimi.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr.51 Prot, datë 17.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 Prot, datë 20.05.2019, ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
  - Certifikatë pronësie për Sheq i Madh, me numër pasurie 44/6, me datë lëshimi 09.08.2017.
  - Certifikatë pronësie për Fier Drizë, me numër pasurie 93, me datë lëshimi 09.11.2017.
  - Certifikatë pronësie për Fier Gjonçë, me numër pasurie 267/10, me datë lëshimi 09.11.2017.
  - Certifikatë pronësie për Lavdan Mallakastër, me numër pasurie 549, me datë lëshimi 18.12.2017.
  - Vërtetim dokument hipotekor nga ZRPP përkatëse për Drenovë mallakastër, me numër pasurie 1/6, me datë lëshimi 27.04.2018.
  - Vërtetim dokument hipotekor nga ZRPP përkatëse për Balldren Elbasan, me numër pasurie A, me datë lëshimi 24.07.2018.
  - Certifikatë pronësie për Cërrik Elbasan, me numër pasurie 12/289, me datë lëshimi 24.04.2019.

Sa më sipër, rezultoi se kushti i vendosur në vendimet e bordit të ERE-s, përkatësisht nr. 187 dhe nr.188, datë 10.11.2017, që lidhet me dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, është plotësuar tërësisht nga shoqëria “Albgaz” sh.a..

- Dokumentacioni i cili mbetet për t’u plotësuar në vijim deri në datën 20.06.2019, nga ana e shoqërisë “Albgaz” sh.a është si më poshtë:

- Pajisja me Lejet dhe Autorizimet Mjedisore; (neni 9, pika 1, germa “d”, vi), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”
- Depozitimi në ERE i Certifikatës së Sigurimit të lëshuar nga shoqëri sigurimi; (neni 9, pika 1, gërma “e”, iv), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:
  - *“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”*
2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:
  - *“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”*
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**